



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**  
**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

---

**RREGULLORE E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT  
“BACHELOR” NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE PËR VITIN AKADEMIK 2019–2020**

1. Të drejtën për të konkurruar e gëzojnë të gjithë nxënësit që janë diplomuar në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe në arsimin e mesëm profesional sportiv ose jo sportiv, të cilët kanë përfunduar konform rregullores së MAS, detyrime të Maturës Shtetërore në vitin akademik 2018 – 2019.
2. Mbështetur në VKM Nr. 295 dt. 10.05.2019, kanë të drejtë të regjistrohen për të konkurruar të gjithë kandidatët që kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë) e lart.
3. Data e konkurrimit si dhe kuota e pranimit, përcaktohen nga Universiteti “A. Xhuvani”.
4. Rregulloren e konkurrimit, Normat e pranimit, në programin e studimit "Bachelor" në edukim fizik dhe sporte si dhe Skedën Shëndetësore Individuale, të interesuarit mund ta gjejnë në faqen zyrtare të Universitetit “A.Xhuvani”, [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al). Gjithashtu një kopje do e tërheqin në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në momentin e regjistrimit për konkurrim. Bashkëngjitur do të gjeni skedën e kontrollit shëndetësor dhe datën e caktuar për fillimin e regjistrimit për konkurrim, si dhe datën e zhvillimit të konkursit.
5. Konkuruesit që rezultojnë me probleme të shëndetit, humbasin të drejtën e përfshirjes në konkurrim.
6. Njoftimi për datën, orën dhe vendin e organizimit të konkurrimit, shpallet dy javë para datës së konkurrimit. Njoftimi shpallet në median vizive e të shkruar. Ju mund ta kërkonti atë edhe në adresën e internetit të UE, [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)
7. Konkuruesit të paraqiten në konkurrim me uniformë sportive.
8. Dokumentat e vlefshme për regjistrim janë:
  - Dokument personal identifikimi me fotografi. (Kartë identiteti dhe fotokopje e saj, ose Pasaporte dhe fotokopje e saj).
  - Skeda shëndetësore e dhënë nga institucioni, e cila vërteton gjendjen shëndetësore të konkuruesit në përballimin e sforcimeve fizike, e plotësuar nga mjekë të specialitetit në rrethin ku i interesuari banon.
  - Dy fotografi.
  - Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit.

9. Konkurruesi përfiton 60% të pikëve nga konkurrimi sportiv dhe 40% të pikëve nga rezultati i maturës shtetërore.
10. Rezultati shumë i mirë vetëm në një disiplinë sportive ndikon, por jo domosdoshmërisht vendos për suksesin e konkurruesit.
11. Numri maksimal i pikëve në konkursin praktik është 70 pike:
  - Atletikë 18 pikë (6 pikë vrapimi 100 m, 6 pikë vrapimi 800 m dhe 6 pikë kërcimi nga vendi.
  - Gjimnastikë 17 pikë (9 pikë akrobaci dhe 8 pikë kërcim kaluçi)
  - Basketboll 18 pikë (9 pikë cirkuidi dhe 9 pikë gjuajtje të lira)
  - Volejboll 17 pikë (9 pikë shërbimet dhe 9 pikë pasimet)
12. Konkurruesi duhet të grumbullojë minimumi 15 pikë për të kualifikuar në konkursin praktik.
13. Sasia e pikëve të grumbulluara nga konkurruesi në 4 disiplinat sportive: Atletikë, Gjimnastikë, Volejboll, Basketboll, si rregull mbledhen me pikët e përfutuara nga matura shtetërore. Shuma e këtyre pikëve do të përbëjë rezultatin përfundimtar të pikëve që grumbullon çdo konkurrues.

**DREJTUESI I DEPARTAMENTIT**

**DEKANI**

**Doc. dr. Edmond BIÇOKU**

**Prof.as.dr.Valentina HAXHIYMERI**